

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 3886/prot

Koplik më: 29 / 12 / 2025

**V E N D I M**

*Nr 64 datë 24/12/2025*

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 24.12.2025, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022 "PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

**VENDOSI**

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. **Mario Mitaj** me motivacionin:

"Për punën, përkushtimin e profesionalizmin e tij në fushën e sportit e në veçanti atij të futbollit duke u shpallur edhe finalist në Kampionatin European të Futbollit 2024 me fanellën e Ekipit tonë Kombëtarë të Futbollit për të na bërë krenarë gjithë malësorët e mbarëshqiptarët kudo që janë duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjërë".

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miraturar me 24.12.2025

Vota Pro 25

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 29.12.2025






REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 3886/prot

Koplik më: 23/12/2025

**Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe**  
**Propozim për dhënie titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e**  
**Madhe z. Mario Mitaj**



Mario Mitaj është i datëlindjes 6 Gusht 2003 dhe ka lindur në Athinë, Greqi  
Moshë kur ka filluar të luaj futboll i përket asaj 6 vjeç. Ekipet me emër që ka luajtur e luan  
janë: ne fillim me skuadrat amatore ne Nea Ionia dhe ne moshën 11 vjeç është zgjedhur  
nga ekipi i superligës greke AEK i Athinës dhe ka vazhduar aty deri ne moshën 17 vjeç gjë që  
e kanë bërë profesionist të skuadra e parë e AEK ku ka qëndruar aty deri në moshën 19



vjeç. Më pas ka luajtur me Lokomotiven e Moskes dhe aty ka ndenjur 2 vite. Tani luan në ekipin arab **AL ittihadi** me komtrate 3 vjecare (2025- 2028 ). Por ajo që e bëri mjaft të njohur për atdhetarinë e kontributin e tij në futboll ishte veshja e fanellës Kombëtare Shqiptare të Futbollit që nga viti 2018 duke qënë një ndër mbrojtësit më të mire shqiptarë. Mori pjesë me ekipin Kombëtarë në Finalet Europiane të 2024. Mario Mitaj vjen nmgja një familje me tradita të denja malësore e atdhetare nga Vermoshi i Kelmendit, Malësi e Madhe.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e Madhe me

**motivacion:**

*“Për punën, përkushtimin e profesionalizmin e tij në fushën e sportit e në veçanti atij të futbollit duke u shpallur edhe finalist në Kampionatin European të Futbollit 2024 me fanellën e Ekipit tonë Kombëtarë të Futbollit për të na bërë krenarë gjithë malësorët e mbarëshqiptarët kudo që janë duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjërë“.*

**KRYETAR BASHKIE**

**TONIN MARINAJ**

